



Universiteti i Prizren "Ukshin Hoti"

Fakulteti i Filologjisë

PROGRAMI MËSIMOR							
Niveli i studimeve	katëvjeçar	Programi	Gjuhë dhe Letërsi Gjermane		Viti akademik	2021/2022	
LËNDA		Gjuhë shqipe I					
Viti	I	Statusi i lëndës	Obligative	Kodi		ECTS kredi	4
Semestri	1						
Javët mësimore	15		Orët mësimore		Ligjërata	Ushtrime	
					2	2	
Metodologjia e mësimimit	Gjatë realizimit të orës praktikohet metodologjia interaktive, duke e bërë studentin pjesëmarrës aktiv jo vetëm në ushtrime, por edhe në ligjërata						
Konsultime							
Mësimdhënës	Prof. asoc. dr. Xhafer Beqiraj	e-mail	xhafer.beqiraj@uni-prizren.com				
		Tel.	+383 (0)44 950 - 369				
Asistenti		e-mail					
		Tel.					

Qëllimi studimor i lëndës	Përfitimet e studentit
<p>Lënda ka për qëllim që studentët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të kuptojnë drejt objektin e studimit të disiplinës së morfologjisë, e cila është njëra nga disiplinat mjaft të rëndësishme të gjuhës. Njohja në nivel të duhur të <i>Gjuhës shqipe I</i> (Morfologji) do t'u ndihmojë studentëve të Programit të Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane të mësojnë dhe përvetësojnë më lehtë dhe më mirë gramatikën e gjermanishtes; - të aftësohen për njohjen sa më të mirë të klasave të fjalëve (pjesëve të ligjërates) të ndryshueshme dhe të pandryshueshme; - ta zbatojnë drejtshkrimin e trajtave të fjalëve dhe t'i kuptojnë mirë kategoritë gramatikore të tyre; - t'i shkruajnë drejt trajtat e fjalëve në fjali; -t'i zhvillojnë aftësitë e komunikimit dhe transmetimit të dijes së tyre; - të jenë në gjendje të zbatojnë njohuritë e fituara nga fusha e morfologjisë; - të aftësohen për punë kërkimore-hulumtuese individuale e grupore; -t'i zhvillojnë aftësitë për të hulumtuar, krahasuar, analizuar e për të sintetizuar etj. 	<p>Pikësynim kryesor i lëndës është që studentët:</p> <ul style="list-style-type: none"> -të kuptojnë se njohja e morfologjisë së shqipes është me rëndësi të veçantë jo vetëm për të zotëruar në nivel të duhur gjuhën amtare, por përmes saj studentët do ta kenë më të lehtë mësimin e gramatikës së gjermanishtes; -t'i përvetësojnë klasat e fjalëve (pjesët e ligjërates) të ndryshueshme dhe të pandryshueshme dhe t'i dallojnë mirë ato, si: <ul style="list-style-type: none"> -pjesët e ndryshueshme të ligjërates; - pjesët e pandryshueshme të ligjërates; - fjalët e lakueshme: emrat, mbiemrat, përemrat, numërorët dhe fjalët e zgjedhueshme – foljet; -t'i përvetësojnë kategoritë gramatikore të secilës klasë; -të kuptojnë mirë fjalëformimin dhe t'i kuptojnë tipat e fjalëformimit; - njohja e mirë e morfologjisë do t'u ndihmojë atyre edhe në zotërimin e sintaksës, sepse pa zotërimin e mirë të morfologjisë nuk ka mundësi të zotërohet mirë sintaksa; -të fitojnë njohuri dhe të përvetësojnë normën gramatikore;

	-të kuptojnë prirjet e përgjithshme të zhvillimit të gjuhës.
--	--------------------------------------------------------------

Metodologjia për realizimin e temave mësimore:			
ECTS-sistemi evropian i transferimit dhe procesi i akumulimit të kredive është një sistem i orientuar kah denti dhe paraqet vleftën e ngarkesës së tij për të arritur objektivat e një lënde (kursi) ose programi të caktuar studimit.			
Ngarkesa e studentit sipas ECTS bazohet në kohën që nevojitet për t'i kompletuar aktivitetet e planifikuara th një lënde (kursi) siç janë: pjesëmarrja në ligjërata, aktiviteti dhe pjesëmarrja në ushtrime, puna në terren, gatitja e projekteve dhe plankonspekteve, prezantimet dhe mbajtjet e orëve, punimet seminarike, puna konsultative me mentorin, puna e pavarur në bibliotekë ose në shtëpi, përgatitja përfundimtare e provimit, koha aluar në provim dhe parametra të tjerë.			
Kushtet për realizimin e temës mësimore:			
Laptop, projektor, shkumës, tabelë etj.			
Mënyra e vlerësimit të studentit (në%)			
	Vlerësimi në %	Nota përfundimtare	
	91% -100%	10 (dhjete)	
	81% - 90%	9 (nëntë)	
	71% - 80%	8 (tetë)	
	61% - 70%	7 (shtatë)	
	51% - 60%	6 (gjashtë)	
	50%	5 (pesë)	
Obligimet e studentit:			
Ligjërata Pjesëmarrja në ligjërata dhe përgatitja e punimeve seminarike dhe eseve janë obligative	Ushtrime Analizë morfologjike e fjalive.		
Ngarkesa e studentit për lëndën			
Aktiviteti	Orë	Ditë/Javë	Gjithsej:
Ligjërata	2	15 Javë	30
Ushtrime teorike	1	15 javë	15
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15 Javë	15
Seminalet	1	2 javë	2
Koha e studimit të pavarur në biblioteka	1	15 javë	15
Projektet, prezentimet,	1	4 javë	4
Detyra të shtëpisë	1	15 Javë	15
Përgaditja përfundimtare për provim	1	2 javë	2
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	2 javë	2
Vërejtje: Po qe se vlefta e 1 ECTS kredie është 25 orë, atëherë rezulton se për ta përgatitur provimin e lëndës së <i>Gjuhës shqipe I</i> , studentit i duhen 100 orë pune. Kjo del edhe kur 100 orë pjesëtohen me 25, rezulton se lënda ka vleftë prej 4 kredish.			100

Java	Ligjërata		Ushtrime	
	Tema	O r ë t	Tema	O r ë t
1.	- Objekti studimor i morfologjisë; - lidhjet e morfologjisë me sintaksën dhe fonetikën; - kuptimet gramatikore dhe format gramatikore.	2	Ushtrime lidhur me objektin e morfologjisë; Kuptimet gramatikore dhe format gramatikore.	2
2.	- Klasat e fjalëve (pjesët e ligjëratisë); - struktura morfologjike e fjalës: fjala, morfema, llojet e morfemave; - morfemat rrënjore dhe ndajshesore.	2	Ushtrime dhe analiza për strukturën e fjalës (morfema rrënjore dhe ndajshesore).	2
3.	- Parashtesat, prapashtesat, mbaresat dhe nyja; - tema e fjalës: tema e parme, jo e parme dhe tema fjalëformuese.	2	Ushtrime lidhur me morfemat ndajshesore dhe temën e fjalës.	2
4.	Tipat e fjalëve sipas strukturës: - mënyrat e tipat e fjalëformimit: - prejardhja, kompozimi, përngjitja, konversioni dhe nyjëzimi.	2	Ushtrime për tipat e fjalëformimit: Prejardhjen, përbërjen, përngjitjen dhe konversionin.	2
5.	Klasa e ndryshueshme – emri: kategoritë gramatikore: numri, gjinia, trajta dhe rasa; - lakimi dhe tipat e tij; - formimi i emrave.	2	Ushtrime lidhur me emrin dhe kategoria gramatikore dhe veçoritë e tjera të tij.	2
6.	Klasa e mbiemrit dhe kategoritë gramatikore: gjinia, numri, rasa dhe shkalla; - mbiemrat e nyjshëm dhe të panyjshëm; - formimi i mbiemrave.	2	Ushtrime për klasën leksikore të mbiemrit dhe veçoritë e tij.	2
7.	Përemri dhe llojet e tij; - kategoritë gramatikore të secilit prej tyre.	2	Ushtrime dhe analiza për përemrat dhe veçoritë e tyre.	2
8.	Klasa e ndryshueshme e foljes: - kategoritë gramatikore, - foljet ndihmëse, gjysmëndihmëse.	2	Ushtrime dhe analiza për foljen: kategoritë gramatikore etj.	2

9.	Zgjedhimi i foljes (tri zgjedhimet) dhe trajtat e pashtjelluara.	2	Ushtrime lidhur me zgjedhimin e foljeve.	2
10.	Ndajfolja dhe veçoritë e saj; klasifikimi i ndajfoljeve dhe formimi i tyre.	2	Ushtrime dhe analiza për ndajfoljen dhe karakteristika e saj.	2
11.	Parafjala dhe veçoritë e saj; klasifikimi i parafjalëve.	2	Ushtrime për parafjalën dhe klasat dhe funksionet e tyre.	2
12.	Lidhëza dhe veçoritë e saj, klasifikimi i lidhëzave.	2	Ushtrime për lidhëzat bashkërenditëse dhe nënrenditëse.	2
13.	Pjesëza dhe pasthirrma; veçoritë e tyre.	2	Ushtrime për pjesëzat dhe pasthirrmat.	2
14.	Njohuri elementare për morfologjinë gjenerative (valencën).	2	Ushtrime për valencën	2
15.	Analiza, diskutime për klasat e ndryshueshme dhe të pandryshueshme (të pjesëve të ligjëratës).	2	Ushtrime dhe analiza për klasat e ndryshueshme dhe të pandryshueshme të ligjëratës.	2

LITERATURA

1. ASHSH, *Gjuha shqipe I*, IGJLSH, Tiranë, 2002.
2. Memushaj, Rami, *Morfonologji e eptimit të shqipes standarde*, Infbotues, Tiranë, 2012.
3. Beci, Bahri, *Gramatika e gjuhës shqipe*, EDFA, Tiranë, 2010.
4. Beqiraj, Xhafer, *Funksionet semantiko-sintaksore të mbiemrit në gjuhën shqipe*, mirgeeralb, Tiranë, 2016.

VËREJTJE

Nuk do të ketë kurrfarë tolerime për “huazim” nga interneti apo kudo tjetër. Punimet e njëjta apo të ngjajshme gjithashtu do të ndëshkohen. Rekomandohet që punimet që dorëzohen të jenë të shkruara me kompjuter.

Vërejtje për studentin:

Studentët duhet t’u përmbahen rregullave të përcaktuara sipas Statutit të UPZ-së dhe rregulloreve dhe vendimeve të miratuara nga Senati i UPZ-së dhe këshilli mësimor.

Pritet që secili student të vijë me kohë.

Nga çdo student pritet që të marrë pjesë në çdo ligjëratë. Për shkak të natyrës dhe mënyrës së mësimin në këtë lëndë, ardhja në mësim dhe pjesëmarrja aktive në diskutim është e domosdoshme. Çdo mungesë e vazhdueshme rezulton me zbritjen e notës finale. Studentët janë të obliguar të kenë sjellje të mirë dhe të mbajnë qetësi, si dhe t’i shkyçin telefonat mobilë gjatë ligjëratave.